



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICUSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
Hajvau - Prishtinë



Nr. / Br. 01-01-1795/4

Data / Datum 08.11.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇESHTJE TË BRENDSHME
DHE ANKESAT

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS



Nr. 1214/3 prot

**RAPORT I INSPEKTIMIT
MBI VLERËSIMIN E EFIKASITETIT TË SHËRBIMEVE TË
PËRBASHKËTA TË POLICIMIT RRUGOR TË POLICISË SË KOSOVËS
DHE POLICISË SË SHTETIT SHQIPTAR NË TERRITORIN E
SHQIPËRISË**

Nr. 3./2017

31 tetor 2017

Informata të përgjithshme

Titulli Raport i inspektimit mbi vlerësimin e efikasitetit të shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Shqipërisë

Data e përgatitjes 31 tetor 2017

Përgatitur nga Ilir Idrizaj, inspektor (IPK),
Ergys Shehu, specialist (SHÇBA),
Xhavit Fetahaj, inspektor (IPK),
Henri Naqellari, specialist (SHÇBA)

Mbikëqyrur nga Ilir Idrizaj,
Udhëheqës i Divizionit për Inspektim dhe Raportim (IPK)
Florian Sulejmani,
Shef i Sektorit të Inspektimit të Përgjithshëm (SHÇBA)

Mbështetur nga Bujar Mustafa,
Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi (IPK)

Dorëzuar nga Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit,
Inspektorati Policor i Kosovës
Oltion Shehu, Drejtor i Inspektimit dhe Ankesave,
Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa

Miratuar nga Hilmi Mehmeti,
Kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës,
Ministria e Punëve të Brendshme (Kosovë)

Eduard Merkaç,
Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit për Çështje të Brendshme e Ankesa,
Ministria e Punëve të Brendshme (Shqipëri)

Data e miratimit 31 tetor 2017

1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2. Qëllimi.....(6-6)
- 2.3. Objekti.....(6-6)
- 2.4. Subjekti.....(6-6)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10. Drejtimit e inspektimit.....(8-8)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(8-9)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(9-9)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Organizimi dhe funksionimi i patrullimeve të përbashkëta.....(10-12)
- 3.2 Indikatorët e performancës së patrullave të përbashkëta policore...(13-15)
- 3.3 Pajisjet dhe mjetet policore të nevojshme për patrullim.....(15-16)
- 3.4 Vlerësimi i të priturve të qytetarëve mbi aktivitetet e përbashkëta.....(16-17)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(18-19)

Shtojcat

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Me hyrjen në fuqi të *Memorandumit të Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar në territorin e Republikës së Shqipërisë*, strukturat policore të të dyja vendeve tona, të përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës (DPP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPSH) kanë ndërmarrë veprimet konkrete të nevojshme përgatitore planifikuese lidhur me zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të dyja vendeve. Palët nënshkruese të Memorandumit të Bashkëpunimit kanë hartuar urdhra (plane) operative që përcaktojnë objektivat dhe veprimet konkrete operative të strukturave policore të dy vendeve, drejt realizimit dhe zbatimit të Memorandumit. Nga data 01.07.2017, siç është paraparë në Memorandum, për periudhën dy (2) mujore janë angazhuar nga Policia e Kosovës (PK) gjithsej gjashtë (6) ekipe patrulluese, të cilat kanë asistuar në ekipet e përbashkëta patrulluese me ato shqiptare, me nga tri (3) patrulla policore, me nga dy (2) punonjës. Ekipet patrulluese janë mbështetur nga tri automjete policore, kanë funksionuar nga dhjetë (10) ditë secila dhe kanë qenë të akomoduar në Lezhë. Këto burime sipas planëzimeve të Drejtorisë Vendore e Policisë në Lezhë janë përcaktuar me shërbime të patrullimeve të përbashkëta në Seksionet e Menaxhimit të Qarkullimit Rrugor në Mirditë dhe Lezhë, si dhe Policinë Rrugore të Stacionit të Policisë në Shëngjin. Ekipet e përbashkëta patrulluese të të dyja policive kanë aplikuar kontrole dhe vëzhgim të mbarëvajtjes së qarkullimit rrugor, duke qëndruar nëpër pika statike, në vende të identifikuar si “njolla të zeza”. Oraret e angazhimit të njërive policore të patrullave të përbashkëta janë aplikuar në dy turne (ndërrime) ditore, varësisht nga fluksi i automjeteve përgjatë Rrugës së Kombit. Për shkak të numrit të kufizuar të personelit të paraparë me Memorandumin e Bashkëpunimit, vlerësohet se ka qenë e pamundur të mbulohen plotësisht me aktivitet patrullues, të dy ndërrimet gjatë javës.

1.1.2. Sipas Drejtorisë së Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit (PSH), gjatë sezonit veror të këtij viti ka pasur shtim të theksuar të aktivitetit policor dhe ngritje të performances policore në akset rrugore ku janë zhvilluar shërbime të patrullimit të përbashkët. Indikatorët e performancës tregojnë se gjatë vitit 2017 ka pasur shtim të numrit të patrullimeve të përbashkëta policore, shtim të pikave të kontrollit dhe shtim të numrit të gjobave të shqiptuara për kundërvajtje në trafik. Krahasuar me vitin e kaluar, gjatë këtij sezoni veror është shënuar rënie e numrit të ngjarjeve (aksidenteve) të komunikacionit të shkaktuara brenda zonave ku janë zhvilluar shërbime të përbashkëta të patrullimit. Brenda kësaj zone të përgjegjesisë, nuk janë shënuar ngjarje (aksidente) me pasoja të rënda (vdekje), ka pasur rënie të numrit të ngjarjeve (aksidenteve) me pasoja/ lëndime të rënda trupore dhe rënie të numrit të (ngjarjeve) aksidenteve me pasoja/ lëndime lehta trupore. Indikatorët e sigurisë rrugore tregojnë se në këtë sezon, kemi pasur një ngritje të lehtë të numrit të (ngjarjeve) aksidenteve rrugore me dëme materiale, në krahasim me sezonin e njejtë të vitit të kaluar.

1.1.3. Paraqitja profesionale me kapacitete të duhura teknike dhe njerëzore të zyrtarëve policorë gjatë aktivitetit patrullues dhe kontaktit me qytetarët luan rol me rëndësi në mbajtjen e standardit të përcaktuar policor dhe krijimin e një perceptimi apo imazhi pozitiv të funksionimit të një policie të kompletuar dhe profesionale, andaj punonjësit policorë të patrullave janë të obliguar të jenë të kompletuar sipas rregullit të përcaktuar me pajisje e duhura për patrullim. Inspektimi ka vënë në pah se, patrullat policore ishin të pajisura me automjete, me uniforma zyrtare brenda standardit dhe

pajisje tjera personale. Është vërejtur mungesë e pajisjeve teknike për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike dhe pajisjeve radio-komunikuese. Vlerësohet se deri te mungesa e pajisjeve për matje të shpejtësisë tek këto patrulla policore, ka ardhur si rezultat edhe i mungesës së theksuar të këtyre pajisjeve brenda PSH-së. Pajisjet për matjen e shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike që janë pronë e PK-së, nuk kanë mundur të përdoren në patrullimet e përbashkëta brenda territorit shqiptar, për arsye se nuk janë të kalibruara nga institucioni kompetent i Republikës së Shqipërisë. Pa një proces të tillë, organi administrativ shtetëror apo Gjykata Administrative nuk e njuh fuqinë e provës gjatë procedurës administrative dhe gjyqësore lidhur me kundërvajtjet e shkaktuara nga ngasësit në trafik. Duhet cekur edhe mangësinë e mos kompletimit të të gjitha patrullave policore, me pajisje policore për trajtimin e aksidenteve në komunikacion. E dukshme është mungesa e foto kamerave, reflektorëve për ndriçim të vendit të aksidentit dhe metrit matës.

1.1.4. Qytetarët e intervistuar nga ekipi i inspektimit të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) dhe Shërbimit për Çështje të Brendshme dhe Ankesa (SHÇBA), kanë shprehur opinion pozitiv lidhur me organizimin e patrullimit të përbashkët të të dyja policive dhe e kanë mirëpritur një veprim të tillë. Ata janë shprehur të kënaqur dhe përkrahin prezencën e këtyre njësive policore për bashkëpunim në policimin rrugor, drejt ngritjes së sigurisë rrugore. Një numër i konsideruar i tyre janë deklaruar se nuk kanë njohuri të mjaftueshme për organizimin e këtyre patrullimeve të përbashkëta, derisa gjendjen e sigurisë përgjatë akseve rrugore e konsiderojnë të mirë. Askush nga qytetarët e kontaktuar nuk ka shprehur ankesë sa i përket sjelljeve të policëve patrullues nëpër këto akse, por kishte të atillë që nuk kishin njohuri të mjaftueshme mbi atë se, në cilat instanca mund të drejtohen, nëse konsiderojnë se në ndonjë situatë të caktuar atyre mund t'u shkelen të drejtat.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi rezultoi se nga pesë (5) rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar, gjithsej janë përmbushur dy (2) rekomandime dhe tre (3) rekomandime tjera nuk janë përmbushur (*për më tepër referoju tabelës në shtojcë*).

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të legjilacionit përkatës që rregullon fushëveprimtarinë e SHÇBA-së dhe IPK-së, këto agjenci kanë mandat ligjor që të kryejnë inspektime në policitë përkatëse të të dyja vendeve (PSH dhe PK), për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Aktiviteti inspektues ndihmon për të siguruar shërbime profesional policore, demokratike dhe të përgjegjshme. Fushë me interes për inspektim kësaj radhe ka qenë menaxhimi i sigurisë rrugore përgjatë rrugëve me fluks të shtuar të pjesëmarrësve në trafik, me theks të veçantë në drejtimet dhe akset rrugore ku frekuenton masë e shtuar e automjeteve dhe qytetarëve nga Kosova. Periudha që përfshinë sezonin veror turistik kërkon angazhim të ekipeve të përbashkëta patrulluese të të dyja vendeve, me qëllim të ndërmarrjes së masave pro-aktive dhe reaktive në sigurinë rrugore. Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm, Ligjin e IPK-së, Ligjin e SHÇBA-së, dhe në përputhje me Planin e punës inspektuese të miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së, njësitë e inspektimit të agjencive mbikëqyrëse të të dyja vendeve, kanë zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm (të pa planifikuar) nga data 22.08.2017 deri me 23.08.2017.

2.2. Qëllimi

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, përfshirë edhe Memorandumin e Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor, zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet,
- Që të përcaktohet nëse burimet policore janë shfrytëzuar në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e vëna,
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me këtë fushë të menaxhimit,
- Që të parandaloj shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë aktivitetit të dy policive,
- Të identifikoj mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandoj masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të patrullimeve të përbashkëta.

2.3. Objekti

2.3.1. Në këtë inspektim është vlerësuar efikasiteti i shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të PK-së dhe PSH-së, në territorin e Shqipërisë gjatë sezonit turistik veror.

2.4. Subjekti

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në strukturat përkatëse policore të policive të të dyja vendeve, me theks të veçantë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Qarkullimit Rrugor të PSH-së të Republikës së Shqipërisë dhe Divizionin e Komunikacionit Rrugor të PK-së të Republikës së Kosovës.

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që ka synuar t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i respektimit të Memorandumit të Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor nga policitë e dyja vendeve në territorin e Shqipërisë,
- Vlerësimi i performancës policore në ngritjen e sigurisë në qarkullimin rrugor në periudhën e sezonit turistik veror, me fluks të shtuar të lëvizjes së automjeteve dhe qytetarëve,
- Vlerësimi i të priturve të qytetarëve mbi bashkëpunimin policor në fushën e patrullimit të përbashkët policor,
- Vlerësimi i pajisjeve dhe mjeteve policore të nevojshme për patrullim,
- Vlerësimi i përmbushjes së rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2016.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të inspektimit luan rol të rëndësishëm në:

- Rritjen e sigurisë së qytetarëve nga policitë e të dyja vendeve,
- Rritjen e besimit të qytetarëve tek policitë e vendeve tona,
- Përmirësimin e shërbimeve të sigurisë në të ardhmen,
- Parandalimin dhe luftimin e korrupsionit,
- Parandalimin e rreziqeve tjera ndaj sigurisë publike,
- Rritjen e cilësisë së shërbimeve të sigurisë që ofrojnë policitë e dy vendeve,
- Forcimin e bashkëpunimit dhe imazhit të policive të dy vendeve.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit;

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me:
 - Drejtorin e Policisë Rrugore pranë DPPSH-së- Drejtues Mit'hat Tola,
 - Shefin e Sektorit për Sigurinë Rrugore- Drejtues Skënder Ismaili,
 - Shefin e Sektorit të Qarkullimit Rrugor në Drejtorinë Vendore të Policisë në Lezhë, Kryekomisar Adriatik Huti,
 - Qytetarë të rastit që kanë lëvizur në rrugët e mbikëqyrura nga ekipet e përbashkëta policore patrulluese (22 marrje opinionesh).
- b) Është inspektuar:
 - Prezenca fizike e patrullave policore sipas planizimit operacional,
 - Gjendja e automjeteve policore,
 - Dokumentet operative dhe pajisjet për punë.
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit lidhur me:
 - Pajisjet dhe dokumentet e automjeteve zyrtare,
 - Pajisjet personale të policëve patrullues,
 - Pajisjet dhe dokumentet operative për patrullim.

- d) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim.
- Urdhri Operativ për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të përbashkëta të policisë rrugore për rritjen e sigurisë rrugore ndërmjet PK-së dhe Policisë rrugore të Shqipërisë (nr. 758, i datës 13.07.2017),
 - Urdhri Operativ ‘Zbatimi i Memorandunit të Bashkëpunimit në mes të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Republikës së Kosovës - 2017’ (04/03/184/2017, i datës 30.06.2017),
 - Plani Operacional për zbatimin e legjislacionit rrugor nga drejtuesit e mjeteve rrugore për parandalimin e shkeljeve burim aksidentesh (nr.4672, datë 13.07.2017),
 - Raport përmbledhës i Divizionit të Komunikacionit rrugor (DKRR)- patrullimi i përbashkët në territorin e Shqipërisë, 01.07.2017-31.08.2017 (04/03/240/2017, datë 18.09.2017),
 - Raport përmbledhës i Drejtorisë të Policisë Rrugore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në Memorandunit të Bashkëpunimit mbi organizimin e shërbimeve të përbashkëta të PK-së dhe PSH-së në akset kryesore rrugore të Republikës së Shqipërisë (shtator 2017).

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në punën Planin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 22.08.2017 dhe ka përfunduar me datë 23.08.2017.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave për periudhën gjatë sezonit veror të këtij viti, nga data 30.06.2017 e deri me 01.09.2017.

2.10. Drejtimet e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi dhe funksionimi i patrullimeve të përbashkëta,
- Indikatorët e performancës së patrullave të përbashkëta policore,
- Pajisjet dhe mjetet policore të nevojshme për patrullim,
- Vlerësimi i të priturve të qytetarëve mbi aktivitetet e përbashkëta.

2.11. Kriteret e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza ligjore në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve dhe e specialistëve gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në strukturat e policore:

- Ligji i Policisë së Republikës së Kosovës (04-L-076),
- Ligji për Policinë e Shtetit (nr. 108/2014),
- Memorandumi i Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar, në territorin e Republikës së Shqipërisë (nr. 01/0426 dhe nr. 4988/3, të datës 30.06.17),

- Urdhri Operativ për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të përbashkëta të policisë rrugore për rritjen e sigurisë rrugore ndërmjet PK-së dhe Policisë rrugore të Shqipërisë (nr. 758, i datës 13.07.2017),
- Urdhri Operativ ‘Zbatimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Republikës së Kosovës - 2017’ (04/03/184/2017, i datës 30.06.2017),
- Plani Operacional për zbatimin e legjislacionit rrugor nga drejtuesit e mjeteve rrugore për parandalimin e shkeljeve burim aksidentesh (nr.4672, datë 13.07.2017),

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. IPK-ja dhe SHÇBA-ja vlerësojnë se gjatë punës inspektuese në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Planin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Organizimi dhe funksionimi i patrullimeve të përbashkëta

3.1.1. Memorandumi i Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor në territorin e Republikës së Shqipërisë ka për qëllim rritjen e elementeve të sigurisë rrugore gjatë sezonit turistik qershor - shtator të këtij viti. Sipas këtij Memorandumi, kërkohet angazhim i përbashkët i njëjësive policore të të dyja vendeve për organizimin e patrullimeve për të parandaluar aksidentet e mundshme, evidentimin e kundërvajtjeve dhe respektimin e normave të sjelljes nga përdoruesit e rrugës. Me dispozitat e Memorandumit, obligohen strukturat përgjegjëse të të dyja policive që të ndërmarrin masat dhe veprimet konkrete planifikuese, drejt zbatimit të saj. Me hyrjen në fuqi të Memorandumit në fjalë, DPP-ja kishte nxjerrë Urdhrin Operativ ‘Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Republikës së Kosovës- 2017’, me qëllim që të vendoset bashkëpunimi konkret gjatë kësaj periudhe dhe të ndërmerren masa të duhura në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të numrit të aksidenteve në komunikacion, si dhe rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, që qarkullojnë në akset rrugore që lidhin dy vendet. Detyrat dhe veprimet konkrete janë bazuar me planet e hartuara nga Drejtoria e Policisë Rrugore, për t’u zbatuar nga patrullat e përbashkëta të të dyja policive, në akset rrugore brenda territorit shqiptar, ashtu siç ka përcaktuar neni 4 i Memorandumit.

3.1.2. Me Urdhrin Operativ të hartuar nga PK-ja, Drejtoritë Rajonale Policore, konkretisht Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor (NJRKRR) dhe Njësia për Kontrollin e Autostradave (NJKA) janë ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi të zbatimit të Memorandumit, duke angazhuar personelin policor më pajisjet e nevojshme për organizimin e policimit të përbashkët. Bartës i implementimit të Urdhrit Operativ në nivel të lartë drejtues të PK-së, ka qenë Drejtori i Drejtorisë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor dhe Shefi i Sektorit për Bashkëpunim e Përkrahje në Komunikacionin Rrugor. NJRKRR-të dhe NJKA-ja kanë caktuar nga dy (2) zyrtarë policorë, me gjithsej gjashtë (6) zyrtarë dhe tre (3) automjete që do të punonin në territorin e Republikës së Shqipërisë për dhjetë (10) ditë pune sipas orarit me Urdhër Operativ/ planëzim të shërbimit. Personi përgjegjës për koordinimin e zyrtarëve policorë të PK-së ishte caktuar një punonjës me gradë rreshter, i cili në përfundim të ndërrimit dhjetë (10) ditor kishte detyrë të hartojë raportin përmbledhës të aktivitetit të policimit të përbashkët patrullues në territorin shqiptar. IPK-ja dhe SHÇBA-ja çmon përpjekjet dhe përkushtimin e strukturave policore të PK-së në marrjen e masave përgatitore dhe planifikuese, drejt rezultateve pozitive të zbatimit të Memorandumit për patrullim të përbashkët policor.

3.1.3. Pas nënshkrimit të Memorandumit, DPPSH-ja ka nxjerrë ‘Urdhër Operativ për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të policisë rrugore të përbashkëta ndërmjet PK-së dhe shërbimeve të Policisë rrugore të Shqipërisë, për rritjen e sigurisë gjatë sezonit turistik veror 2017’. Nëpërmjet këtij Urdhri, DPPSH-ja ka urdhëruar Departamentin për Siguri Publike që nëpërmjet Drejtorisë së Policisë Rrugore, të marrë masat e nevojshme për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e shërbimeve të përbashkëta ndërmjet policive të të dyja vendeve. Me këtë Urdhër janë përcaktuar drejtoritë kompetente të ngarkuara me detyra dhe përgjegjësi zbatuese, si dhe pozitat e larta drejtuese për kontrollin dhe zbatimin e tij. Në pajtim me Urdhrin, është bërë edhe shpërndarja e punonjësve të PK-së në kuadër të Seksionit të Menaxhimit të Trafikut Rrugor në Lezhë me dy (2) automjete zyrtare e katër (4) punonjës policie dhe në atë Mirditës me një (1) automjet dhe dy

(2) punonjës policie, seksione këto në kuadër të Sektorit të Policisë Rrugore pranë Drejtorisë Vendore së Policisë në Lezhë. IPK-ja/SHÇBA-ja çmon përpjekjet dhe përkushtimin e strukturave policore të PSH-së për mobilizim dhe ndërmarrjen e masave përgatitore për zbatim të suksesshëm të Memorandumit për patrullim të përbashkët policor.

3.1.4. Bazuar në legjislacionin në fuqi, Departamenti i Sigurisë Publike në kuadër të DPPSH-së, ka hartuar Planin Operacional për zbatimin e legjislacionit rrugor nga drejtuesit e mjeteve rrugore për parandalimin e shkeljeve burim aksidentesh¹. Plani ka përcaktuar një numër masash për ngritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, parandalimin e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor dhe zbatimin e normave që burojnë nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë. Plani ka përcaktuar veprime dhe aktivitete konkrete të strukturës policore dhe bartësit e zbatimit të tij. IPK-ja dhe SHÇBA-ja çmon përpjekjet dhe përkushtimin e strukturave policore të PSH-së për marrjen e masave operative planifikuese me qëllim të ngritjes së sigurisë në komunikacion, parandalimit të shkeljeve të mundshme të rregullave të Kodit Rrugor.

3.1.5. Memorandumi ka përcaktuar që akomodimi dhe trajtimi më ushqim i punonjësve të PK-së për periudhën dy mujore të bëhet nga Drejtoria Vendore e Policisë në Lezhë. Nga komunikimi me punonjësit e PK-së të përfshirë në shërbimet e patrullimeve të përbashkëta, është konstatuar se kushtet e ofruara nga pala pritëse kanë qenë të kënaqshme dhe se nuk kishte vërejtje. Për dallim nga viti i kaluar kur ekipet e patrullimit të PK-së ishin akomoduar në Durrës, këtë vit akomodimi i tyre ishte zhvendosur në Lezhë. Ky ka qenë një veprim i duhur menaxherial, ngase për patrullat e përbashkëta që operonin në Lezhë dhe Mirditë, përbente një distancë të konsiderueshme prej 100 km rrugë, që duhej përshkuar deri në zonën apo vendin e kryerjes së shërbimeve patrulluese. Me akomodimin e policëve patrullues afër zonave ku planifikohet ofrimi i shërbimeve patrulluese, shmanget kostoja e shërbimeve të rrugës, ngarkesat ditore apo lodhja nga udhëtimet e stërgjatura. IPK-ja dhe SHÇBA-ja çmon angazhimin e menaxherëve të të dyja policive për zgjidhjen, si dhe eliminimin e vështirësive për policët kosovar gjatë detyrave të shërbimeve të përbashkëta.

3.1.6. Përzgjedhja e policëve patrullues për përmbushjen e detyrave të përcaktuara të policimit rrugor, është bërë nga udhëheqësit e NJRKRR-ve dhe NJKA-së, duke aplikuar kriteret për policët e dalluar që kanë treguar integritet të lartë dhe përkushtim në shërbim. Para nisjes, ekipet policore kanë mbajtur takime njoftuese me drejtuesit kompetent të PK-së, për marrjen e instruksioneve për detyrat dhe kompetencat e njësive policore që dalin nga Memorandumi dhe Urdhri Operativ, kurse me të arritur në Shqipëri, në takimet me drejtues të strukturës policore të PSH-së ishin njoftuar me aktet normative që përcaktojnë rregullat e qarkullimit rrugor në Shqipëri, procedurat standarde të punës dhe kushtet specifike të punës së shërbimeve të Policisë rrugore gjatë sezonit turistik.

3.1.7. Zonat e mbikëqyrjes të qarkullimit rrugor, në të cilat është planifikuar të shtrihen shërbimet e patrullimit të përbashkët policor me pjesëmarrje të gjashtë (6) patrullave policore, ka përfshirë akset rrugore: Rrëshen - Milot, Milot - Lezhë dhe Lezhë - Shëngjin. Ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 të Memorandumit, çdo ditë në fillim të orarit të punës, patrullat policore janë përfshirë në takimet njoftuese, në të cilat janë njoftuar me detyrat, orarin patrullues dhe aktivitete tjera. Kryerja

¹ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Departamenti i Sigurisë Publike, *Plani Operacional për zbatimin e legjislacionit rrugor nga drejtuesit e mjeteve rrugore për parandalimin e shkeljeve burim aksidentesh*, nr. 4672, datë 13.07.2017, Tiranë.

e shërbimeve të përbashkëta të patrullimit kryesisht është përqendruar në të ashtuquajturat ‘njolla të zeza’, të vlerësuara si vende, zona apo akse rrugore ku janë përcjellur në të kaluarën me aksidente me pasoja të rënda në njerëz dhe me dëme materiale. Po ashtu, disa patrulla policore gjatë orarit ditor të punës janë vendosur në kryqëzime rrugësh me frekuentim apo ngarkesë të madhe të qarkullimit rrugor. Roli i këtyre patrullave ka përfshirë edhe rregullimin e rrjedhës së qarkullimit rrugor me qëllim të parandalimit të ngjarjeve (aksidenteve) të komunikacionit dhe eliminimit të kolonave (ngecjeve) të gjata në trafik.

3.1.8. Orari i angazhimit të njësive policore të patrullimeve të përbashkëta është aplikuar në dy turne (ndërrime): ndërrimi i paradites, kur ka fluks madh të hyrjes së qytetarëve në Republikën e Shqipërisë, dhe ai i pasdites, kur ka fluks në drejtim të daljes nga territori shqiptar në drejtim të Kosovës. Varësisht prej nevojave që dalin si rezultat i fluksit të madh të lëvizjes së automjeteve, patrullimi për ditët: e hënë, e martë, e mërkurë, e enjte dhe e shtunë, është aplikuar nga ora 07:00 deri në ora 15:00, ndërsa të premtën dhe të dielën, nga ora 15:00 deri në orën 23:00. Për shkak që Memorandumi ka paraparë vetëm nga gjashtë (6) punonjës të PK-së që të shërbejnë në kuadër të policimit të përbashkët, ky numër është vlerësuar të jetë i pamjaftueshëm për të mbuluar plotësisht dy ndërrimet me aktivitetet patrullues gjatë tërë javës.

Rekomandimi nr. 1

SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës që në të ardhmen të rishikojnë nenin 2, paragrafi 1 të Memorandumit të Bashkëpunimit, me qëllim të shtimit të numrit të policëve patrullues për të siguruar kapacitete optimale të resurseve njerëzore për mbulim të plotë me shërbime të patrullimeve të përbashkëta për të dy ndërrimet (turnet), gjatë tërë javës.

3.1.9. Zyrtarët policorë të PK-së e kryejnë patrullimin në rrugë në kuadër të ekipeve të përbashkëta me oficerët policorë të PSH-së. Nga inspektimi i patrullave në terren, u konstatua se patrullimi është kryer në formë të kombinuar, një (1) zyrtarë i Policisë rrugore të PSH-së ka patrulluar me një (1) zyrtarë policorë të PK-së, duke arritur në gjashtë (6) numri i patrullave të përbashkëta. Nga specialistët e SHÇBA-së dhe inspektorët e IPK-së janë inspektuar pesë (5) ekipe patrulluese me përbërje të kombinuar për patrullim të përbashkët. Këto patrulla janë hasur nëpër vendet/lokacionet e planëzuara për patrullim brenda orarit ditor të punës. Ishte inkurajues fakti se të gjitha patrullat e përbashkëta janë gjendur brenda orarit ku është planifikuar të shërbejnë.

3.1.10. Patrullat policore të patrullimit të përbashkët u janë përgjigjur rasteve të aksidenteve që janë shkaktuar brenda zonave të përgjegjësisë së tyre ku ishin të planëzuar të ushtrjnë aktivitetet patrullues. Në kuadër të njësive policore patrulluese janë trajtuar rastet e aksidenteve të trafikut me dëme materiale dhe me lëndime të lehta trupore. Për rastet tjera të aksidenteve me fatalitet dhe me lëndime të rënda trupore, patrullat e përbashkëta policore u janë përgjigjur rreth sigurimit të vendit të ngjarjes dhe për t’u kujdesur për drejtimin e qarkullimit të trafikut rrugor deri në ardhjen e njësive tjera të specializuara për trajtimin e aksidenteve.

3.2. Indikatorët e performancës së patrullave të përbashkëta policore

3.2.1. Nga fillimi i aktivitetit të përbashkët patrullues, në kuadër të Drejtorisë Vendore të Policisë në Lezhë, gjashtë (6) ekupe patrulluese kanë asistuar me shërbim, ku në kuadrin e së cilës prej tyre janë angazhuar nga tre (3) patrulla policore, me nga dy (2) punonjës dhe duke u shërbyer me tre (3) automjete të PK-së. Secili ekip patrullues ka qenë aktiv për një periudhë në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditësh. Ndarja dhe kombinimi i burimeve njerëzore në kuadër të patrullave të përbashkëta është kryer në pajtim me nenin 5 të Memorandumit të Bashkëpunimit. Burimet njerëzore dhe teknike sipas planëzimeve të Drejtorisë përkatëse të PSH-së janë përcaktuar me shërbime të patrullimeve të përbashkëta sipas kësaj formule shpërndarëse:

- një (1) patrullë policore e PK-së në aksin rrugor Skuraj - Rrëshen - Tuneli i Kalimashit, në bashkëpunim me një (1) patrullë policore të Seksionit të Menaxhimit të Qarkullimit Rrugor të Mirditës, duke u kombinuar në dy (2) patrulla të përbashkëta policore,
- një (1) patrullë policore e PK-së në aksin rrugor Lezhë - Milot, në bashkëpunim me një (1) patrullë policore të Seksionit të Menaxhimit të Qarkullimit Rrugor të Lezhës, duke u kombinuar në dy (2) patrulla të përbashkëta policore,
- një (1) patrullë policore e PK-së në aksin rrugor Shëngjin - Rëra e Hedhur, në bashkëpunim me një (1) patrullë policore të Policisë rrugore të Stacionit të Policisë në Shëngjin, duke u kombinuar në dy (2) patrulla të përbashkëta policore.

3.2.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi i patrullave të përbashkëta policore në akset rrugore është vlerësuar se ka funksionuar mjaft mirë. Kur i referohemi mënyrës së funksionimit si patrullë e përbashkët gjatë ndaljes së automjeteve në rrugë, është vërejtur se policët patrullues janë koordinuar në marrjen e veprimeve policore, siç është definuar me Memorandum dhe Urdhër Operativ. Në rastet kur kanë identifikuar kundërvajtësit e trafikut, automjetet janë ndaluar duke iu komunikuar arsyeja e ndaljes, iu është kontrolluar dokumentacioni, ndërsa shqiptimi i masave administrative (gjobave) për shkelje të Kodit Rrugor është kryer nga policët patrullues të Policisë rrugore të PSH-së. Policët patrullues të PK-së të përfshirë në patrulla të përbashkëta policore nuk kanë shqiptuar gjoba, ngase nuk kanë patur mandat ekzekutiv gjatë realizimit të patrullimit të përbashkët në territorin shqiptar, meqë një kompetencë e kësaj natyre nuk është përcaktuar në Memorandum. Vlerësohet se sanksionet administrative janë aplikuar sipas legjislacionit shqiptar, siç është përcaktuar në nenin 5 të Memorandumit.

3.2.3. Patrullat policore të PK-së kanë qenë të pajisura më formularët e Fletë-patrullimeve, të cilat përdoren për të pasqyruar aktivitetet ditore nga terreni, por meqë patrullimet janë funksionalizuar brenda territorit shqiptar, ato nuk janë praktikuar në terren. Është vërejtur se patrullat e përbashkëta nuk kanë mbajtur shënime ditore mbi kronologjinë e aktiviteteve të patrullimit ditor. Duhet sqaruar se punonjësit e Policisë rrugore nuk aplikojnë praktikë apo procedurë për mbajtjen e shënimeve ditore gjatë aktivitetit patrullues në terren. Duke kuptuar këtë lloj patrullimi si një praktikë specifike të bazuar në Memorandumin aktual, vlerësohet se do të ishte praktikë e mirë që në drejtim të sigurimit të një llogaridhënjeje më efikase, të aplikohen praktika të mbajtjes së shënimeve ditore nga ana e patrullave të përbashkëta policore. Në mungesë të shënimeve ditore, ishte e pamundur të verifikohesh aktiviteti patrullues i patrullave të përbashkëta.

Rekomandimi nr. 2

SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon menaxherëve të përfshirë në planet e policimit të përbashkët rrugor që të shqyrtojnë mundësitë e aplikimit të procedurës së raportimit më cilësor të aktiviteteve ditore të patrullave policore përmes 'Fletë patrullimeve', drejt ngritjes së nivelit të llogaridhënies dhe raportimit.

3.2.4. Referuar në pikën 2, të kapitullit 4 të Urdhrit Operativ të PK-së, ishte me interes të verifikohet mënyra e raportimit të ekipeve patrulluese. Gjatë inspektimit janë kërkuar raportet e ndërrimeve të ekipeve të patrullimeve që kanë zhvilluar aktivitete të përbashkët për periudhën dhjetë (10) ditore. Është konstatuar se, në përfundim të qëndrimit dhjetë (10) ditor të ekipeve kosovare të patrullimeve në territorin e Shqipërisë, nga udhëheqësit e tyre janë përpiluar raporte mbi rrjedhën e aktivitetit të përbashkët policor. Raportet e tilla i janë dorëzuar Drejtorisë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor në Divizionin e Komunikacionit Rrugor të PK-së, që në pajtim me Urdhrin Operativ është caktuar të jetë bartës i implementimit të Urdhrit. Ndërsa, në kuadër të strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë në Lezhë, për ndryshim nga viti i kaluar, janë hartuar raporte lidhur me ecurinë e aktiviteteve të patrullimeve të të dyja policive, pas çdo turni (ndërrimi) dhjetë (10) ditor. Kjo mënyrë e raportimit pasqyron performancën e treguar dhe rrjedhën e ngjarjeve gjatë aktiviteteve të patrullimit të përbashkët për shërbimin dhjetë (10) ditor të ekipeve patrulluese. Në fund të sezonit turistik veror, pas përmbylljes së aktivitetit të policimit të përbashkët rrugor, pala dërguese² e përfaqësuar nga Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe pala pritëse³ e përfaqësuar nga Drejtoria e Policisë Rrugore, kanë hartuar raporte të ndara përmbledhëse mbi tërë aktivitetin e policimit të përbashkët dhe rezultatet e arritura gjatë ecurisë së bashkëpunimit të policive të të dyja vendeve.

3.2.5. Nëse shikohen parametrat e sigurisë rrugore për zonat ku kanë vepruar ekipet dhe patrullat policore, sipas të dhënave të Drejtorisë së Policisë Rrugore për dy (2) vitet krahasuese (2016 dhe 2017), pasqyrohet rënie për 13% e numrit të përgjithshëm të ngjarjeve (aksidenteve), rënie për 63% të numrit të aksidenteve me pasoja/ lëndime të rënda trupore dhe rënie për 33% të numrit të aksidenteve me pasoja/ lëndime lehta trupore. Është shënuar një ngritje e lehtë për 7% të numrit të aksidenteve rrugore me dëme materiale. Gjatë të dy viteve të fundit, në kuadër të zonave ku janë zhvilluar shërbime të patrullimit të përbashkët nuk janë shënuar raste të ngjarjeve (aksidenteve) me pasoja të rënda (vdekje). Gjatë këtij viti ka pasur një shtim të theksuar të aktivitetit policor dhe ngritje të performancës policore në akset ku janë zhvilluar shërbimet e patrullimit të përbashkët. Indikatorët e performancës shënojnë ngritje për 314% të numrit të patrullimeve të përbashkëta gjatë sezonit veror të këtij viti në krahasim me sezonin e njejtë të vitit të kaluar. Gjatë këtij viti ka pasur ngritje për 217% të numrit të pikave të kontrollit dhe për 125% të numrit të gjobave të trafikut. Krahasuar me vitin 2016 kur brenda dite janë shqiptuar mesatarisht 24 gjoba nga të gjitha patrullat me afërsisht katër (4) gjoba për patrullë, këtë vit janë shqiptuar mesatarisht 54 gjoba në ditë, me mesatare prej nëntë (9) gjoba për patrullë. SHÇBA-ja/IPK-ja çmojnë angazhimin dhe përkushtimin në ngritjen e performancës së ekipeve dhe patrullave të përbashkëta policore, drejt krijimit të një ambient më të sigurt rrugor. Njëherësh, inkurajohen dy policitë që në të ardhmen, duke marrë parasysh interesin e dy anshëm, të vazhdojnë me ndërmarrjen e masave parandaluese, për të kontribuar në reduktimin e ngjarjeve (aksidenteve) me pasoja në njerëz dhe dëme materiale.

² Pala dërguese, konform Memorandumit të Bashëpunimit dhe Urdhrit Operativ, nënkupton Policinë e Kosovës,

³ Pala pritëse, konform Memorandumit të Bashëpunimit dhe Urdhrit Operativ, nënkupton Policinë e Shtetit Shqiptar,

Tabela nr. 1. Paraqitja tabelore mbi masat parandaluese policore, indikatorët e performancës së njësive policore në shërbimet e përbashkëta patrulluese dhe ngjarjet që lidhen me sigurinë rrugore					
Nr.	Indikatorët e performancës policore dhe të sigurisë rrugore	2016	2017	+/-	%
1.	Numri i patrullimeve të përbashkëta	42	174	+132	+314%
2.	Numri i pikave të kontrollit	12	38	+26	+217%
3.	Numri i kundërvajtjeve të shqiptuara	1.450	3.264	+1.814	+125%
4.	Aksidente me pasoja të rënda (vdekje)	0	0	0	0
5.	Aksidente me pasoja/lëndime të rënda trupore	8	3	-5	-63%
6.	Aksidente me pasoja/lëndime lehta trupore	24	16	-8	-33%
7.	Aksidente rrugore me dëme materiale	45	48	+3	+7%

3.3. Pajisjet dhe mjetet policore të nevojshme për patrullim

3.3.1. Paraqitja profesionale dhe e kompletuar e patrullave policore gjatë aktivitetit patrullues dhe kontaktit me qytetarët, luan rol të madh në rritjen e standardit dhe prezantimin e imazhit të një policie sa më profesionale dhe të përgjegjshme. Bazuar në Memorandumin Bashkëpunimit dhe Urdhrin Operativ, policët e patrullave të përbashkëta policore janë obliguar të jenë të kompletuara sipas rregullave të përcaktuara, me uniformë policore, mjete rrugore të uniformuara dhe pajisje të nevojshme për kryerjen e shërbimeve policore. Të gjithë punonjësit e patrullave të inspektuara kanë qenë të kompletuar me uniformë të rregullt zyrtare dhe me armë zyrtare. Një (1) punonjës i PSH-së, i caktuar në orarin e patrullimit tek “Kryqëzimi i Rrilës”, nuk ka poseduar shufër metalike. Prej pesë (5) patrullave policore të inspektuara, dy (2) prej tyre nuk kanë qenë të pajisura me pajisje të radio-komunikimit. Mungesa e pajisjeve të radio-komunikimit tek disa patrulla është pasojë e mosfurnizimit, defekteve evidente dhe mospërdorimit të tyre për shkak të pambulueshmërisë së zonës patrulluese me valë të rrjetit të radio-komunikimit.

Rekomandimi nr. 3

SHÇBA/IPK rekomandon Drejtuesit e Drejtorisë së Policisë Rrugore të PSH-së dhe Shefat e Seksioneve të Qarkullimit Rrugor në Drejtorinë Vendore të Policisë në Lezhë, që të marrin masat e nevojshme për furnizim dhe kompletim të njësive me pajisje mbështetëse të nevojshme të punës për patrullat e policimit të përbashkëta.

3.3.2. Patrullat e përbashkëta policore ishin pajisur me automjete zyrtare të uniformuara, pajisje të nevojshme për patrullim dhe pajisje për trajtim të aksidenteve të komunikacionit. Gjatë inspektimit të pesë (5) automjeteve patrulluese, të gjitha kanë qenë të kompletuar me kuti të ndihmës së parë dhe me trekëndëshin e paralajmërimit. Tre (3) automjetet e PK-së kanë qenë të pajisura me librezat e qarkullimit dhe autorizime për të drejtën e ngasjes së tyre jashtë vendit, kurse për dy (2) automjetet e PSH-së nuk janë prezantuar librezat e qarkullimit. Tre (3) automjetet e PK-së kanë qenë të pajisura me formularët e udhëtimit sipas rregullave mbi përdorimin e automjeteve të PK-së, kurse për dy (2) automjetet e PSH-së, nuk janë prezantuar formularët e tillë. Tre (3) automjetet e PK-së kanë qenë të pajisura me pajisjet kundër zjarrit, kurse dy (2) automjetet e PSH-së nuk kanë qenë të pajisura me këto pajisje. Vlerësohet se deri mungesa e disa prej pajisjeve në automjete policore të PSH-së ka ardhur si rezultat i mosfurnizimit dhe neglizhencës së personelit kompetent për të mirëmbajtur (kujdesur) për automjetet policore.

3.3.3. Të gjitha patrullat e përbashkëta policore, në ditën kur është zhvilluar inspektimi, kanë qenë të pajisura me tabela dore (stopa), me pajisje për detektimin e prezencës së alkoolit tek ngasësit (etilometra/ alkolteste) dhe kona për kufizimin e hapësirës për ndaljen dhe kontroll të automjeteve. Për shkak të materialeve, nga të cilat janë punuar uniformat zyrtare të policëve shqiptarë, pjesët me përmbajtje reflektuese janë të materializuara në vetë uniformën policore. Në anën tjetër, policët kosovarë në kuadër të patrullave të përbashkëta kanë qenë të pajisur me jelekë reflektues. Asnjëra nga pesë (5) patrullat e inspektuara, nuk ka qenë e pajisur me matës të shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve motorike. Deri te mungesa e këtyre matësve në kuadër të patrullave të përbashkëta ka ardhur si rezultat i mungesës së theksuar të këtyre pajisjeve brenda PSH-së. Policët patrullues nga PK-ja nuk kanë qenë të pajisur me matës të tillë, për shkak të pamundësisë së përdorimit të tyre në teritorin e Shqipërisë. Mungesa e matësve ka pasur efekt negativ për shkak se ka pamundësuar ndëshkimin e shkelësve të Kodit Rrugor për tejkalimin e shpejtësisë së kufizuar.

Rekomandimi nr. 4

SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë së Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, që të ndër marrin masat e nevojshme për furnizimin me matësit e shpejtësisë së lëvizjes për njësitë policore që ushtrojnë aktivitete patrulluese në sigurinë e trafikut rrugor.

3.3.4. Për trajtimin aksidenteve që shkaktohen brenda zonave të përgjegjësisë, njësitet patrullimit duhet të jenë të pajisura me pajisje elementare si: shirit rrethues, matës të gjatësië (metër), foto kamerë dhe reflektorë për ndriçimin e vendit të ngjarjes. Nga inspektimi i pesë (5) patrullave policore, ka rezultuar se të gjitha ato kanë qenë të pajisura me shirit për rrethimin e vendngjarjes, dy (2) patrulla policore nuk kanë qenë të pajisura me foto kamera, tre (3) patrulla policore nuk kanë qenë të pajisura me reflektor për ndriçim të vendngjarjes si dhe një (1) patrullë nuk ka pasur matës për matje të gjatësisë (distancës) në vendngjarje. Deri te mungesa e disa prej pajisjeve për trajtimin e aksidenteve ka ardhur për shkak të mosfurnizimit dhe neglizhencës së shërbimit logjistik. Mungesa e këtyre pajisjeve shkakton vështirësi në cilësinë e trajtimit të aksidenteve.

Rekomandimi nr. 5

SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë së Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, Divizionit të Komunikacionit Rrugor të Policisë së Kosovës, si dhe shërbimeve logjistike të të dyja policive, që në të ardhmen të marrin masat e nevojshme për furnizimin/kompletimin adekuat të patrullave policore, me pajisjet e nevojshme për trajtimin e aksidenteve.

3.4. Vlerësimi i të priturve të qytetarëve mbi aktivitetet e përbashkëta

3.4.1. Rendi dhe siguria publike është parakusht për lirinë e lëvizjes, qarkullimin e lirë të njerëzve mallrave dhe shërbimeve, si dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarë. Një rëndësi të madhe, policitë e dyja vendeve do t'i kushtojnë ngritjes së shkallës së besimit në raport me komunitetin. Po ashtu, theks i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me qytetarë në parandalimin/ zvogëlimin e aksidenteve të komunikacionit, me qasje parandaluese të identifikimit, analizimit dhe zgjidhjes së problemit. Në funksion të vlerësimit të pritjeve të qytetarëve mbi bashkëpunimin e dy policive, në ngritjen e sigurisë rrugore, janë marrë opinione nga një numër qytetarësh (përdorues të rrugës, të cilët janë hasur duke lëvizur me automjetet e tyre në akset, Milot- Morinë dhe Milot-Lezhë.

3.4.2. Qytetarët e intervistuar nga ekipi i inspektimit, kanë shprehur opinionet e tyre lidhur me perceptimin qytetar për rolin e organizimit dhe patrullimit të përbashkët të policive të të dyja vendeve. Nga 22 qytetarë të intervistuar, shtatë (7) prej tyre janë shprehur se nuk kanë njohuri për organizimin e patrullimeve të përbashkëta. Por, të gjithë kanë vlerësuar pozitivisht organizimin e bashkëpunimit të dy policive dhe janë shprehur për vazhdimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Deri të mos informimi i një numri i të qytetarëve, vlerësohet të ketë ardhur si rezultat i mungesës së fushatave (programeve) informuese nga policitë e dyja vendeve. Informimi i qytetarëve përbën një dritare të komunikimit dhe bashkëpunimit Polici-qytetar, me qëllim të ngritjes së besimit të ndërsjellë.

Rekomandimi nr. 6

SHÇBA/IPK u rekomandon menaxhmenteve (drejtuesve) të të dyja Drejtorive të Përgjithshme të Policisë (Shqipëri dhe Kosovë) që në të ardhmen të organizojnë programe (fushata) informuese lidhur me bashkëpunimin dhe organizimin e aktiviteteve të policimit të përbashkët të dy policive.

3.4.3. Lidhur me gjendjen e sigurisë rrugore në akset ku zhvillohen patrullime të përbashkëta, qytetarët e intervistuar kanë dhënë opinione e tyre. Prej 22 të intervistuarve, katër (4) prej tyre kanë vlerësuar si jo të mirë gjendjen e sigurisë dhe vërejtjet e tyre lidhen me mungesën e shenjëzimit (sinjalistikës) adekuat në këto akse rrugore. Të intervistuarit tjerë e kanë vlerësuar si të mirë gjendjen e sigurisë rrugore. SHÇBA-ja dhe IPK-ja kuptojnë se vendosja/ mirëmbajtja e shenjëzimit në akse rrugore është kompetencë e institucioneve tjera gjegjëse, duke besuar se struktura e Policisë rrugore është e gatshme të ngrisë shqetësimet e saj tek institucionet përgjegjëse, sa herë që vlerëson se duhet kërkuar mirëmbajtje adekuate të sinjalizimit të akseve rrugore. Tetë (8) të intervistuar kanë pohuar se kanë hasur në ekipe patrulluese të përbashkëta. Qytetarët e intervistuar i vlerësojnë pozitivisht dhe korrekte sjelljet e patrullave të përbashkëta dhe nuk kanë ndonjë vërejtje lidhur me punën e tyre. Prej 22 të intervistuarve, tre (3) prej tyre kanë pohuar se janë gjobitur gjatë ngasjes së mjeteve të tyre në këto akse rrugore dhe se arsyet e ndëshkimit kanë qenë për ‘tejkallim të shpejtësisë së kufizuar të lëvizjes’ dhe ‘mosvënie të rripit të sigurisë gjatë ngasjes’. Të gjithë qytetarëve pa dallim, të të dyja vendeve, iu është garantuar e drejta e ankimimit ndaj sjelljeve të çdo punonjësi policor në rast se vlerësojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre dhe se për trajtimin e ankesave kundër policisë ekzistojnë institucionet kompetente si IPK-ja dhe SHÇBA-ja. Inspektimi ka vënë në pah se, prej 22 qytetarëve të intervistuar, 14 prej tyre nuk janë në dijeni për ekzistimin e këtyre dy institucioneve.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja dhe SHÇBA kanë dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmentet policore në takimin përmbyllës të datës 30.10.2017, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Prioriteti	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës që në të ardhmen të rishikojnë nenin 2, paragrafi 1 të Memorandumit të Bashkëpunimit, me qëllim të shtimit të numrit të policëve patrullues për të siguruar kapacitete optimale të resurseve njerëzore për mbulim të plotë me shërbime të patrullimeve të përbashkëta për të dy ndërrimet (turnet), gjatë tërë javës.</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>
2.	<i>SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon menaxherëve të përfshirë në planet e policimit të përbashkët rrugor që të shqyrtojnë mundësitë e aplikimit të procedurës së raportimit më cilësor të aktiviteteve ditore të patrullave policore përmes ‘Fletë patrullimeve’, drejt ngritjes së nivelit të llogaridhënies dhe raportimit.</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>
3.	<i>SHÇBA/IPK rekomandon Drejtuesit e Drejtorisë së Policisë Rrugore të PSH-së dhe Shefat e Seksioneve të Qarkullimit Rrugor në Drejtorinë Vendore të Policisë në Lezhë, që të marrin masat e nevojshme për furnizim dhe kompletim të njësisve me pajisje mbështetëse të nevojshme të punës për patrullat e policimit të përbashkëta.</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>
4.	<i>SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë së Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, që të ndërmarrin masat e nevojshme për furnizimin me matësit e shpejtësisë së lëvizjes për njësitë policore që ushtrojnë aktivitete patrulluese në sigurinë e trafikut rrugor.</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>
5.	<i>SHÇBA-ja/IPK-ja u rekomandon drejtuesve të Drejtorisë së Policisë Rrugore të Policisë së Shtetit, Divizionit të Komunikacionit Rrugor të Policisë së Kosovës, si dhe shërbimeve logjistike të të dyja policive, që në të ardhmen</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>

	<i>të marrin masat e nevojshme për furnizimin/kompletimin adekuat të patrullave policore, me pajisjet e nevojshme për trajtimin e aksidenteve.</i>			
6.	<i>SHÇBA/IPK u rekomandon menaxhmenteve (drejtuesve) të të dyja Drejtorive të Përgjithshme të Policisë (Shqipëri dhe Kosovë) që në të ardhmen të organizojnë programe (fushata) informuese lidhur me bashkëpunimin dhe organizimin e aktiviteteve të policimit të përbashkët të dy policive.</i>		<i>Rekomandimi i qëndrueshëm</i>	<i>Në vitin e parë (2018)</i>

Shtojcat

Shtojca 1. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2016)			Niveli i zbatimit po/jo
	Inspektimi: Vlerësimi i efikasitetit në zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shtetit Shqiptar, në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë sezonës së verës			
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1.	<i>IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumin pasardhës që Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Shqipëri të angazhohen për gjetjen e zgjidhjeve ligjore për njohje dhe vlefshmërinë e kalibrimit për pajisjet e matjes së shpejtësisë (radarëve) dhe alkotesteve nga institucioni përgjegjës i Republikës së Shqipërisë me qëllim vënien në punë të tyre dhe përdorimin pa pasur pengesa ligjore, gjë që do të çonte në parandalimin e aksidenteve rrugore dhe dokumentimin e shkeljeve.</i>			Vlerësimi nga SHÇBA/IPK: <i>I pa implementuar</i>
2.	<i>IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumin pasardhës strukturave përkatëse në Policinë e Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Shqipëri, për shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe pajisje/material nga Policia e Kosovës</i>			Vlerësimi nga SHÇBA/IPK: <i>I pa implementuar</i>
3.	<i>IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumin pasardhës përfshirjen e aksit Durrës-Vlorë për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të patrullimit, pasi është një aks që frekuentohet shumë nga pushuesit kosovar dhe se do të ndikonte për krijimin një ambienti më të sigurt për të gjithë qytetarët në këtë aks</i>			Vlerësimi nga SHÇBA/IPK: <i>I pa implementuar</i>
4.	<i>IPK-SHÇBA rekomandon për memorandumet pasardhëse, drejtuesve të Policisë së Shtetit dhe Policisë së Kosovës që punonjësit e Policisë së Kosovës të planizuar/caktuar për shërbim në Drejtorinë Vendore t’ju sigurohet akomodimi sa më pranë zonave ku janë caktuar në shërbime qëllim shmangien e kostove dhe rritjen e efikasitetit.</i>			Vlerësimi nga SHÇBA/IPK: <i>I implementuar</i>

5.	<i>IPK-SHÇBA rekomandon shefave të seksioneve të qarkullimit/komunikacionit rrugor në Drejtoritë Vendore në Durrës dhe Lezhë të hartojnë dhe administrojnë raporte përmbledhëse për punonjësit e njësisë së patrullimeve të përbashkëta, të cilat ndërrohen në intervalet 10-ditore.</i>			Vlerësimi nga SHÇBA/IPK: I implementuar
----	--	--	--	--